REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
954/20
Data/datum 03.12.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.954/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të Goran Milenković - Kryetar Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "EJONA"SH.P.K - Pejë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: "Ekotermika", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe instalimi i ashensorit në qendrën e kulturës Hasan Prishtina", me nr. të prokurimit: VU644-20-4997-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Vushtrri, më datën: 02.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "EJONA"SH.P.K - Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe instalimi i ashensorit në qendrën e kulturës Hasan Prishtina", me nr. të prokurimit: VU644-20-4997-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Vushtrri.

II. **VËRTETOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe instalimi i ashensorit në qendrën e kulturës Hasan Prishtina", me nr. të prokurimit: VU644-20-4997-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Vushtrri.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "EJONA"SH.P.K - Pejë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 16.11.2020 me nr. 954/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe instalimi i ashensorit në qendrën e kulturës Hasan Prishtina", me nr. të prokurimit: VU644-20-4997-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Vushtrri, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 10, 61, dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 18.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 26.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, është njoftuar nga AK-ja, me letrën standarde te tenderuesit te pasuksesshëm dhe njeherit ne ankesën e tij ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e te rekomanduarit për kontrate.

Ne vazhdim eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, pretendon qe i rekomanduari për kontrate ka ofruar çmim Jo/Normalisht te ulet, me arsyetimin se ne jemi bashkëpunëtor qe disa vite me prodhuesin "Metron" – Greqi me te cilin ka ofertuar edhe OE i rekomanduar për kontrate, dhe nga i njëjti prodhues kemi marr konfirmimin se është e pamundur te behet furnizimi me çmimet te cilat i ka ofruar OE i rekomanduar për kontrate.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ne ankesën e tij e ka bashkangjitur një fature te prodhuesit "Metron", me te cilën pretendon se çmimi i dhëne nga OE i rekomanduar për kontrate është çmim Jo/Normalisht i ulet, te cilën do te ja bashkangjes këtij raporti.

Eksperti shqyrtues lidhur me ketë pretendim fillimisht sqaron se vlerësimi i çmimit sipas dispozitave te nenit 61 te LPP-se, është e drejte e autoritetit kontraktues dhe ne rastin konkret AK-ja, nuk ka vërejtur se ka çmime Jo/Normalisht te ulëta.

Eksperti shqyrtues sqaron se është i paqëndrueshëm pretendimi i OE ankues, lidhur me mosrespektimin e dispozitave te Rregullores për çmime Jo/Normalisht te ulëta, për faktin se ne rastin konkrete, ne ketë aktivitet te prokurimit kane ofertuar vetëm dy operator ekonomik, prandaj është e pamundur te aplikohet formula e dhënë ne rregulloren për çmime jo/normalishte te ulëta dhe njeherit eksperti shqyrtues, sqaron se nuk mund te merret për baze pretendimi i OE ankues se vlera e ofertës se OE te rekomanduar për kontrate është me shume se 25% me e ulet se sa vlera e parashikuar e kontratës.

Pretendimi i OE ankues se AK-ja me rastin e pranimit te kërkesës për rishqyrtim nuk e ka pezulluar automatikisht aktivitetin e prokurimit, nuk qëndron për faktin se sipas dispozitave te nenit 108/A nuk ka një afat te caktuar për ta pezulluar dhe ne sistemin e e-prokurimit gjendet vendimi për pezullim te aktivitet te prokurimit.

Eksperti shqyrtues ne fund sqaron se OE ankues kërkon qe OE i rekomanduar për kontrate te eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se i rekomanduari për kontrate ka dhënë çmim Jo/Normalisht te ulet dhe njeherit kërkon qe aktiviteti i prokurimit te kthehet ne rivlerësim dhe krejt ne fund kërkon qe te anulohet aktiviteti i prokurimit ne fjale me arsyetimin se ka shume shkelje.

Eksperti shqyrtues, sqaron se kërkesa për anulim te aktivitet te prokurimit, përderisa vet OE ankues është i përgjegjshëm sipas autoritetit kontraktues, dëshmon se OE ankues nuk ka interes material ne ketë aktivitet te prokurimit, sipas nenit 4.1.26 te LPP-se, andaj eksperti shqyrtues e vlerëson si te pa bazuar ankesën e OE ankues.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te refuzohet si e pabazuar, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie te kontratës te mbetet ne fuqi.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 26.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se PAJTOHET plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues, si me te gjeturat ashtu edhe me

rekomandimet e dhëne lidhur me lenden ne fjalë. Po ashtu ju lutem qe ta trajtoni ketë lende me urgjencë për shkak te kohës ne te cilën gjendemi.

Operatori Ekonomik, me datë: 26.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se NUK PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues. Nuk pajtohemi aspak me mendimin e ekspertit Visar Basha.

Ne kemi ofruar dëshmi te mjaftueshme për te paraqitur pa rregullsitë qe kanë ndodhur ne ketë aktivitet te cilat sipas mendimit te ekspertit as qe janë shiquar.
Kemi parashtruar kërkesën për Rishqyrtim me datën 26.10.2020 dhe AK as qe e ka shqyrtuar këtë kërkesën tonën.
AK bën planifikimin e nënshkrimit te kontratës me datën 05.11.2020 duke mos respektuar afatet kohore për parashtrimin e ankesave pran OSHP –së. Ndërsa vendimin për refuzim te ankese e nxjerr me datën 05.11.2020 AK, vetëm pasi qe ne e lajmëruam AK –në se bashku me zyrën Rregullative te KRPP-së, se AK është duke bere shkelje për mosrespektimin te afateve.
Nëse ne nuk do kishim marre masat e duhura, AK do ta nënshkruante kontratën ne mënyrë te jashtëligjshme duke shkelur ligje dhe rregulla.
Andaj është e pakuptimit qe eksperti Visar Basha te ktheje përgjigje se Ankesa jone është plotësisht e pa bazuar. Sepse ky mendim i ekspertit është fyerje dhe degradim për një institucion si qeshte OSHP.
Ne kërkojmë nga Paneli i OSHP-së qe ta shqyrtoj ankesën ton dhe ti shiqojë dëshmitë te cilat i kemi ofruar .
Është e pakuptimit qe AK ne ketë rast me gjitha këto shkelje te kaloj pa asnjë vërejtje, ku ne një situatë reale do duhej ta qonte ne suspendim Shefin e Zyrës se Prokurimit!
Ju njoftojmë se nëse OSHP nuk merr masat e duhura për këto shkelje nga Zyra e Prokurimit te "Komuna Vushtrrisë" ne do vazhdojmë me procedura gjygjsore kundër tyre.Andaj na mbetet te shpresojmë për një vendim korrekt dhe legjitim te OSHP-së për ketë aktivitet .

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 02.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimet e OE ankues "EJONA"SH.P.K - Pejë se OE i rekomanduari për kontrate ka ofruar çmim Jo/Normalisht te ulet, me arsyetimin se ne jemi bashkëpunëtor qe disa vite me prodhuesin "Metron" – Greqi me te cilin ka ofertuar edhe OE i rekomanduar për kontrate, dhe nga i njëjti prodhues kemi marr konfirmimin se është e pamundur të behet furnizimi me çmimet te cilat i ka ofruar OE i rekomanduar për kontrate. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues ne ankesën e tij e ka bashkangjitur një fature te prodhuesit "Metron", me te cilën pretendon se çmimi i dhëne nga OE i rekomanduar për kontrate është çmim Jo/Normalisht i ulet, e cila fature ju ka bashkangjitur raportit të ekspertizës.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se vlerësimi i çmimit sipas dispozitave te nenit 61 të LPP-se, është e drejte e autoritetit kontraktues dhe ne rastin konkret AK-ja, nuk ka vërejtur se ka çmime Jo/Normalisht të ulëta. Andaj, është i paqëndrueshëm pretendimi i OE ankues, lidhur me mosrespektimin e dispozitave te Rregullores për çmime Jo/Normalisht te ulëta, për faktin se ne rastin konkrete, ne ketë aktivitet te prokurimit kane ofertuar vetëm dy operator ekonomik, prandaj është e pamundur te aplikohet formula e dhënë ne rregulloren për çmime jo/normalishte te ulëta. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se nuk mund te merret për baze pretendimi i OE ankues se vlera e ofertës se OE të rekomanduar për kontrate është me shume se 25% me e ulet se sa vlera e parashikuar e kontratës.

Lidhur me pretendimet e OE ankues "EJONA"SH.P.K - Pejë se AK-ja, me rastin e pranimit të kërkesës për rishqyrtim nuk e ka pezulluar automatikisht aktivitetin e prokurimit, Paneli Shqyrtues sqaron se dorëzimi i një kërkese për rishqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar (shih par 2 të nenit 108/A të LPP-së). Ku ne sistemin e e-prokurimit gjendet vendimi për pezullim te aktivitet te prokurimit në fjalë. Andaj pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimet e OE ankues "EJONA"SH.P.K - Pejë ku kërkon qe OE i rekomanduar për kontrate te eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se i rekomanduari për kontrate ka dhënë çmim Jo/Normalisht te ulet dhe njeherit kërkon qe aktiviteti i prokurimit te kthehet në rivlerësim dhe krejt në fund kërkon qe të anulohet aktiviteti i prokurimit ne fjale me arsyetimin se ka shume shkelje. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesa për anulim te aktivitet të prokurimit, përderisa vet OE ankues është i përgjegjshëm sipas autoritetit kontraktues, dëshmon se OE ankues nuk ka interes material në ketë aktivitet të prokurimit, sipas nenit 4.1.26 të LPP-se. Andaj, pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Paneli Shqyrtues në bazë të shkresave të lëndës dhe ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, si dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues vjen në përfundim se autoriteti kontraktues ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK KK Vushtrri

1x1 OE "EJONA" shpk -Pejë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.